



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.586/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bean” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-21292-05-09-2019, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti*”, me fond limit 74.258.784 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

**Ankimues:** “Bean” shpk  
Levan, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos  
Lagja “Naftetari”, Rruga “Unaza”

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 09.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-21292-05-09-2019, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti*”, me fond limit 74.258.784 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datën 01.07.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- 4 A-M	55,674,899	I skualifikuar
- Leon Konstruksion	56,437,555.30	I skualifikuar
- Bean	59,054,627	I skualifikuar
- Glavenica	72,259,124	I kualifikuar
- Flondi Konstruksion	73,281,194	I skualifikuar
- Alba Konstruksion	87,864,140	I skualifikuar
- B-93	pa ofertë	I skualifikuar
- Elda VI	pa ofertë	I skualifikuar
- Air Komponent	pa ofertë	I skualifikuar

II.4. Në datën 08.07.2019 operatori ekonomik “Bean” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*1. Nuk ploteson kriterin mbi formularin e ofertes. Operatori ekonomik ka deklaruar sipas formularit te ofertes cmimi total te ofertes 59 054 627 leke pa tvsh. Shuma 59 054 627 TVSH 20% 11 810925 SHUMA TOTAL 70 865 552 Ne preventivin permbleshes bashkelidhur ofertes konstatohet si me poshte SHUMA 1+6 52 523 454 FONDE REZERVE 5 % 2 626 173 SHUMA 1+6 55 149 627 TVSH 11 029 925 MAKINERI E PAJISJE SHUMS 7+11 4 686 000 Operatori ndodhet ne kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundershitim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne kundershitim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera e ofertes pa tvsh duhet te perlllogaritej SHUMA (1+6) + SHUMA (7+11) qe sipas vlerave te preventivit 55 149 627 + 4 686 000 =59 83 5627 leke. Në këto kushte, gjykojm se, vlera e ofertes ekonomike pa TVSH e paraqitur nga ankimuesi, e cila është përlllogaritur duke bërë zbritjen njëherazi edhe të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar të paisjeve, të cilat, referuar UMF ofertohe në vlerë totale vetëm me TVSH, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërcituara. Nga ana tjetër, Komisioni gjykon se përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik ankimues në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja*

*e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .*

*2. Nuk ploteson kriteret mbi mjete e pajisjet qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates pasi nuk disponon certifikat transporti per mjetet me kamiona, kapacitet total mbajtes 2-3 ton. Ne kriteret per kualifikim ne kete procedure prokurimi eshte kerkuar kamiona, kapactet total 2-3 ton. OE sipas formularit te deklarimit per plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur mjetet me targe AA 675 NY dhe AA859LG. Mjeti me targe AA 675 NY sipas lejes se qarkullimit ka kapacitet mbajtes 2021 kg dhe AA859LG ka kapacitet mbajtes 2420 kg , per te cilat OE nuk ka paraqitur certificata transporti. Bazuar në nenet 41 - 47 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar -parashikohet se: “Neni 41 - Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Neni - 42 Kur transporti i mallrave për të tretë dhe me qira kryhet me pagesë, ky çmim të mbështetet në dispozitat e ligjit "Për çmimet dhe tarifat". Neni 43 - Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm për ndërmarrjet që kryejnë transport mallrash për të tretë dhe me qira, brenda vendit, me anë të mjeteve motorike ose të kombinimeve të mjeteve. Kapaciteti maksimal i lejuar i transportimit*

*përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 44 - Llojet e transportit të mallrave me qira dhe për të tretë, të cilat mund të kryhen pa licencë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë. Neni 45 - Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë. Neni 46 - Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg. Neni 47 - Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.” Keto mjete sic shifet tejkalojn kapacitetin transportues prej 1500 kg, në mënyrë që të lind detyrimi për pajisjen me certifikatë transporti sipas parashikimeve ligjore te permendur me siper.*

*3. Nuk ploteson piken 5 te kriterëve te kualifikimit ku kandidati/ ofertuesi duhet te jete i pajisur me license me kod I.2 A dhe license me kod III.2.B. OE ka paraqit keto 2 licensa me kontrate sherbimi me operator te tjere ekonomik te cilat duhet te disponoheshin nga vet operatori . Mbështetur në nenin 63, pika 1 të LPP-së, ku parashikohet shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.” mund te ankimohej mbi kriterin, moment procedural në të cilin mund të ankoheshit për dokumentat e tenderit qe tashmë është ezauruar. Gjithashtu kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë*

paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,

4.Nuk ploteson kriterin 4.2 mbi punonjes te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik per elektricist 5. OE per plotësimin e këtij kriteri ka paraqit 5 punonjes konkretisht H.B, A.V, A.K, L.S si dhe M.M i cili është inxhinier elektrik ne kete procedure prokurimi . Referuar sa me siper autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatoret te deshmojne qe ne stafin e tyre te kene 1 inxhinie(r elektrik me dokumentacion perkates dhe 5 punonjes elektricist (total 1 ing elektrik +5 elektricist) nga shqyrtmi dokumentacioni I paraqit nga OE rezulton qe jane paraqitur 4 punonjes elektricist dhe 1 inxh elektrik, pra nuk ka paraqitur dokumentacion mbi numrin e kerkuar te punonjesve.

5. Me te njejtin arsyetim ligjor ndodhemi dhe per plotësimin e kriterëve 4.3 dhe 4.8 Ne proceduren e prokurimit sipas kriterit 4.3 është drejtues mjetesh automakinist 3 dhe eskavatorist 4 dhe sipas pikes 4.8 është kerkuar 4 punonjes per punime ne lartesi. Pra ne total 7 drejtues mjetesh dhe 4 punonjes ne lartesi. Per plotësimin e ketyre kriterëve OE ka paraqit punonjesit E.K dhe G.K dhe si punonjes ne lartesi dhe si drejtues mjetesh. Per sa me siper ndodhemi ne mospermbushje te kriterëve per kualifikim. Per sa me siper ka praktika ligjore nga KPP.

II.5. Në datën 12.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit ju sqarojmë se: Plotësimi i shtojcës 1 Formulari i Ofertës është plotësuar konform formatit që ndodhet në DST për për objektin në fjalë. Për sqarim makineritë pjesë përbërëse e këtij preventivi janë si më poshtë:

	F kaldaje për shkollat për ngrohje me ujë me lëndë djegëse pelet komplet me instrumentat matës dhe të kontrollit të		
--	---	--	--

7	<i>parametrave të ujit të ngrohte, Q-nominale 250 kë/orë përfshirë montimin e të gjithë tubacioneve dhe të pajisjeve deri në dalje nga dhoma teknike</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
8	<i>F. Plafonier në hollet dhe shkallët Led 3600 lumes komplet me aksesorët</i>	<i>cope</i>	<i>24</i>
9	<i>F Plafonier në klasat dhe laboratorët Led 2250 lumes komplet me aksesorët</i>	<i>copë</i>	<i>180</i>
10	<i>F Prozhektorë Led 200 Ë, ndricimin e sheshit dhe fushës së sportit</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>
11	<i>F Shtylla Ndricimi dekorative</i>	<i>copë</i>	<i>12</i>

*Këto janë artikuj të furnizueshëm brenda vendit dhe blerja e tyre bëhet me tvsh. Po ashtu bashkëlidhur Formularit të Ofertës ndodhet preventivi i ofertës ekzaktësisht me të gjitha hollësitë që edhe ju përmendni. Në zbatimin e kontratës AK bën pagesën e situacioneve mbështetur në preventiv.*

*Mendojmë se pretendimi juaj nuk qëndron.*

- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit ju sqarojmë se: Mjetet e sipërpërmendura janë mjete të qarkullueshme në rrugë dhe është detyrë e policisë në rast të ndonjë parregullsie në dokumentacion të marrë masat paraprake. Në periudhën e rilicensimit të mjetit dhe nëse ai nuk qarkullon mjeti nuk është në shkelje të ligjit.*

*Mendojmë se pretendimi juaj nuk qëndron.*

- *Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit edhe pse arsyetimi juaj është shumë i zgjeruar qëllimi final i një procedure prokurimi është që të realizohet objekti , kryesorja në vlerën më konkurruese. Në raste të ngjashme ku kandidati/ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë me kod 1.2.A dhe licencë me kod III.2.B në procedura të tjera prokurimi , konkretisht me bashkinë Durrës kemi vepruar në të njëjtën formë dhe ka qenë krejt në rregull.*

*Mendojmë se pretendimi juaj nuk qëndron.*

- *Në lidhje me arsyen e katërt të skualifikimit sqarojmë se : Konkretisht Ing. Elektrik Myzejen Majollari është e kualifikuar dhe zotëron të gjithë dokumentacionet e nevojshme për realizimin e punës. Do të ishim në parregullsi nëse nuk do të zotëronte kualifikimet e duhura. Besojmë se është akoma më e saktë kryerja e zërave përkatës nga njëri më të kualifikuar. Në ngjashmëri kemi rastet kur kërkohet që inxhinierë të caktuar të stafit të kenë kualifikime shtesë si mbrojtje ndaj zjarrit, punime në lartësi, vertifikatë për sigurinë dhe shëndetin në punë etj.*

*Mendojmë se pretendimi juaj nuk qëndron.*

- *Në lidhje me arsyen e pestë të skualifikimit sqarojmë se: Referuar grafikut të punimeve periudha kur punonjësit Enea Kelo dhe gentian Kurti i takon në punimet me mjete dhe ato në lartësi nuk përputhen. Pra është kohë më vete kur punohet me mjetet përkatëse dhe tjetër kur punohet në lartësi. Në këtë mënyrë këta punonjës mund të kryejnë punimet për të cilat janë më të kualifikuar.*

*Mendojmë se pretendimi juaj nuk qëndron.*

*Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.*

II.6. Me shkresën nr.1918/1 prot datë 17.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 20.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2090/2 prot datë 05.08.2019 protokolluar me tonën me nr.1309/2 prot datë 08.08.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bean” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “3. Nuk ploteson pikën 5 të kriterëve të kualifikimit ku kandidati/ ofertuesi duhet të jetë i pajisur me license me kod I.2 A dhe license me kod III.2.B. OE ka paraqit keto 2 licensa me kontrate sherbimi me operator të tjere ekonomik të cilat duhet të disponoheshin nga vet operatori . Mbështetur në nenin 63, pika 1 të LPP-së, ku parashikohet shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.” mund të ankimohej mbi kriterin, moment procedural në të cilin mund të ankoheshit për dokumentat e tenderit që tashmë është ezauruar. Gjithashtu kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3/5 ”Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

5. Kandidati/ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencat e mëposhtme:

Licence nga QKB me kod I.2.A



*Licencë nga QKB me kod III.2.A (1+2)*

*Licencë nga QKB me kod III.2.B*

III.1.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 17.06.2019 në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

*Ne lidhje me pikat e licenses : Licence nga QKB me kod I.2.A; Licencë nga QKB me kod III.2.A (1+2);...” po ju sqarojme se :*

*Referuar Urdher nr. 424 date 24.07.2015 “Per miratimin e rregullave teknike per mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin ne objektet e destinuara per banim dhe arsimim, , pikes 7 te saj, si dhe mbeshtetur ne natyren e punimeve te parashikuara ne projekt-preventiv , ku punimet ndertimore jane perqendruar ne arterien kryesore te zones si dhe nga vet rendesia e objektit duke bere nje kufizim drastik ne levizjen e mjeteve, duhet qe operatori ekonomik te kete ne stafin e tij nje ekspert zjarrfikës te certifikuar per te organizuar punet dhe per te mundesuar ne cdo kohe (nepermjet plan organizimeve te punes) koridore kalimi te mjeteve kundra zjarrit (zjarrfikese, autoshkallet etj) ne rast rënie zjarri ne objektet qe preken ne menyre te drejtperdrejt ose terthorazi nga zbatimi i projektit si dhe te beje instruksionet e nevojeshme per rast rënie zjarri. Gjithashtu Eksperti duhet te beje vleresimin e konformitetit te produkteve qe do te perdoren si dhe kërkesat themelore te punimeve te ndërtimit, te cilat përcaktohen ne rregulloret përkatëse e qe duhet te plotësohen nga produktet, duke ruajtur karakteristikat kryesore te qendrushmerise ndaj zjarrit, kjo konform Ligjit nr. 9290 date 7.10.2004 “Per produktet e ndertimit”, neni 4 i saj.*

*Ne vazhdimesi te kerkeses per kriteret teknike dhe detyrat e ekspertit zjarrfikës por edhe te operatorit ekonomik , kerkohet qe gjithë detyrat e mesiperme, ne zbatim edhe te ligjeve te siperpermendura, operatori te jete i pajisur edhe me licensen I.2.A , license per sistemet teknike kunder zjarrit.*

*Ne lidhje me licensen me kod III .2A (1+2) Njesia e prokurimit e ka hequr si kriter nga DST me shtojcën e ngarkuar ne sistem date 21.05.2019.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues ”Bean” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë për ofrim shërbimi Nr.223 Rep, nr.63/1 Kol datë 21.06.2019 lidhur ndërmjet shoqëria Bean shpk dhe shoqëria Ndregjoni shpk me objekt ”Ofrim shërbimi” – Shoqëria Ndregjoni shpk pajisur me Licencë Nr.LN-5328-06-2018, datë 18.6.2019 për Mbrojtjen nga Zjarri’, të lëshuar nga QKL Kodi 1.2.A merr përsipër ti ofrojë shërbimet e nevojshme konform kësaj licence shoqërisë Bean shpk në rast të fitimit të tenderit të mësipërm prej saj.-Licencë me Kod 1.2.A per shoqërinë Ndregjoni shpk

- Kontratë për Ofrim Shërbimi Nr.222 Rep Nr.62/1 Kol lidhur ndërmjet Shoqëria Bean shpk dhe Shoqëria Kupa shpk –Shoqëria Kupa shpk pajisur me Licencë Nr.LN-6605-01-2019 datë 30.01.2019 ”Për grumbullim, transportim i mbetjeve inerte jo të rezikshme të lëshuar nga QKL Kodi III.2.B merr përsipër ti ofrojë shërbimet e nevojshme konfrom kësaj licence Shoqërisë Bean shpk në rast të fitimit të tenderit të mësipërm.-Licence me kod II.2B me objekt Grumbullim transportim i mbetjeve inerte jo të rezikshme.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.6. Referuar kërkesave të autoritetit kontraktor parashikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi KPP konstaton se ky i fundit ka parashikuar që shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin dokumentacion ligjor përkatësisht Licence nga QKB me kod I.2.A, Liçencë nga QKB me kod III.2.B. Nga shqyrtimi i dookumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektornike nuk rezulton të jenë paraqitur licencat e kërkuara në emër të shoqërisë Bean shpk. KPP vëren se janë paraqitur licencat me kod I.2.A dhe me kod III.2.B të cilat janë në emër të personave të tretë të cilët sikundër del nga dokumentacioni i dorëzuar kanë me ankimuesin ofertues në procedurë, marrëdhënie kontraktuale shërbimi.

III.1.7. Sa më sipër KPP gjykon të ndalet në interpretim teleologjik të nenit 46 pika 1 të ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në interpretim të kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor e njëherazi në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, përveçprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP gjykon se licencat, e paraqitura nga operatori ekonomik “Bean” shpk të cilat nuk janë në emër të këtij të fundit nuk mund të konsiderohen të vlefshme në këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon se plotësimi i kërkesave për kualifikim në një procedurë prokurimi shtrihet *strictu sensu* vetëm ndaj operatorëve pjesëmarrës dhe në asnjë rast, operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk mund të përmbushin kapacitetet teknike me anë të dokumentacionit të subjekteve të tjerë juridikë. Dorëzimi i dokumentacionit të një subjekti tjetër i cili nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe as nuk shfaqet në cilësinë e njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve nuk mund të konsiderohet i vlefshëm duke u paraqitur si dokumentacion i vetë pjesëmarrësit. KPP gjykon sese përdorimi i kapacitetit teknik të subjekteve të tjerë juridikë në kuadër të përfitimit të fondeve publike referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, pranohet në rastet e paraqitjes së ofertës në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë në zbatim të nenit 74 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

III.1.8. Akoma më tej në nenin 75 të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, parashikohet se “ 1. Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës. **Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t’ua transferojnë kontratën palëve të treta.** Autoriteti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë. 2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti kontraktor do t’i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit. 3. **Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.** 4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit. 5.

*Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP-së, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.*

*6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kriterëve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues. 7. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.”*

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Bean në asnjë moment nuk rezulton që nga kjo e fundit të jetë marrë konfirmimi i autoritetit kontraktor lidhur me ndonjë marrëveshje të mundshme nënkontraktimi.

III.1.9. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë*

*sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

III.1.10. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;* *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues *“Bean”* shpk shpk duhe të kishte paraqitur dokumentacionin të vlefshëm në përputhje dhe kriteret kualifikuese.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bean” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-21292-05-09-2019, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti*”, me fond limit 74.258.784 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1309 Protokolli; Datë 20.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**